



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 042255528

KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2535

Nr. koleksioni: 797

Tirane më 18/03/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2022053950084738253



A2022053950084738253

KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME
(kuotash kapitali)

Sot, më datë 18.03.2022 (dymije e njezete e dy), perpara meje Noter JULIAN ZHELEGU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqiten:

DHURUES:

Edrian Meslani, atësia Hetem, amësia Violeta, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Tish Daija; Nd. 26; H. 3; Ap. 39; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 04/10/1983, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034475354 dhe nr. personal I310040280;

dhe

PRANUES I DHURIMIT:

Doriana Mamillo, atësia Kristaq, amësia Aferdita, shtetase Shqiptare, lindur në Poliçan, Skrapar dhe banues në TIRANË, me adresë Sulejman Delvina; Nd. 33; H. 1; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 30/01/1984, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033087679 dhe nr. personal I45130031U;

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 761 e vijues i tij; si edhe ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", neni 62, pika 1, gërma "ll", si dhe nenet 99, 100, 101; si dhe Udhëzimit nr. 232, datë 14.1.2016 "Mbi ndryshimin e Pronësisë së mjeteve rrugore" e vijues bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri hartimin e Kontratës së Dhurimit Pasuri e Luajtshme – kuota kapitali, sipas kushteve dhe kritereve ligjore të mëposhtme:

MEQENËSE:

- a. Shoqëria "ERK AUDITING" Sh.p.k, është një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me numer unik identifikimi NUIS K91713008K dhe me seli ne Njesia administrative nr. 7, Rruga "Islam Alla", Ndertesa nr. 67, Kati 3, Ap. 10;
- b. Siç rezulton nga ekstrakti i regjistrimit tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për të dhënat e Shoqërisë, Dhuruesi zotëron 1 kuote e cila perfaqeson 25 % (njezete e pese përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
- c. Dhuruesi i ka njoftuar Pranuesit dëshirën e tij për dhurimin e 25 % (njezete e pese përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë dhe Pranuesi ka pranuar të fitojë kuoten e zotëruar nga Dhuruesi në Shoqëri sipas parashikimeve te kesaj Kontrate;
- d. Në zbatim të kërkesave të Statutit të Shoqërisë dhe pasi transferimi i kuotave sipas kësaj

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti

- 1.1 Dhuruesi i dhuron dhe Pranuesi pranon të fitojë pronësinë mbi 1 kuote e cila perfaqeson 25 % te kapitalit te regjistruar të Shoqërisë "ERK AUDITING" Sh.P.K.
- 1.2 Kuota është e lire nga cdo barrë dhe e garantuar plotësisht sipas kushteve të kësaj Kontrate.

Neni 2 Deklarimet dhe garancite

- 2.1. Dhuruesi pranon se deklarimet e mëposhtme janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate:
 - a. Dhuruesi ligjërisht e në momentin e nënshkrimit zotëron kuoten që do të transferohet sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për ta transferuar kuoten.
 - b. Nënshkrimi apo zbatim i kësaj Kontrate nga Dhuruesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Dhuruesi.



A2022053950084738253

- c. Çdo deklarim apo garanci e dhënë nga Dhuruesi sipas kësaj Kontrate nuk përmban gabime materiale.
- 2.2. Pranuesi pranon se deklarimet e mëposhtme janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate:
- Pranuesi ka tagra të plota për të pranuar kuotat nga Dhuruesi sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.
 - Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Pranuesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marreveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Pranuesi.

Neni 3 Transferimi i të drejtave mbi kuotat

- 3.1 Pronësia mbi kuotën e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Dhuruesit te Pranuesi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Kalimi i pronësisë së kuotes së Shoqërisë në favor të Pranuesit do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 3.2.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, ortak te Shoqërisë do të behen:
- Znj. **Doriana Mamillo, behet zotëruese e 1 (nje) kuote e cila perfaqeson 55 % te kapitalit themeltar te shoqerise "ERK AUDITING" Sh.P.K.; dhe**
 - Znj. **Merita Gjoshaj, mbetet zotërues i 1 (nje) kuote e cila perfaqeson 45 % te kapitalit themeltar te shoqerise "ERK AUDITING" Sh.P.K.;**
- 3.1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesi gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuotat në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4 Të ndryshme

- 4.1. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.
- 4.2. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 4.3. Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale dhe me vlerë të njëjtë provuese. Kontrata e Dhurimit pasuri e luajtshme, u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres. Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; vërtetoj nënshkrimin e tyre.
- Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

DHURUES

Edrian Meslani

PRANUES I DHURIMIT

Doriana Mamillo

NOTER
JULIAN ZHELEGU